

---

**PIK'S SUPERVISORY ROLE IN PROVIDING A RESPONSIBLE, PROFESSIONAL AND DEMOCRATIC POLICE SERVICE**

**Servet Tasholli**

Police inspector, Lipjan, Kosovo, [serveti\\_ipk@hotmail.com](mailto:serveti_ipk@hotmail.com)

**Refik Havolli**

Prishtina, Kosovo, [refik.havolli@gmail.com](mailto:refik.havolli@gmail.com)

**Abstract:** The Kosovo Police Inspectorate (IPK) as an independent supervisory mechanism of the Kosovo Police has shown responsibility, professionalism, impartiality, transparency, credibility and has managed the challenges that have accompanied this institution and the police service in general since August 2006 to the present day.

The Police Inspectorate of Kosovo (PIK) functions based on Law no. 03 / L-231 which entered into force on 1 December 2010. PIK, having an open communication with all stakeholders, such as citizens, internal communication with members of the Kosovo Police, with the Legislative and the Executive, has managed to successfully supervise and manage efficiently Kosovo Police. PIK as an independent Kosovo Police Supervisory Mechanism is based on two main functions, inspecting the manner of performance of duties by the Kosovo Police and investigating all complaints addressed to the Kosovo Police member with the purpose of providing responsible, professional and democratic police service. PIK to be more efficient is supervised by three official levels: the internal level, the level of parliament and the Ministry of Internal Affairs.

**Keywords:** police, inspectorate, communication, transparency

**ROLI MBIKQYRËS I IPK-së NË SIGURIMIN E NJË SHËRBIMI POLICOR TË PËRGJEGJSHËM, PROFESIONAL DHE DEMOKRATIK**

**Servet Tasholli**

Inspektorati Policor i Kosovës, Lipjan, Kosovë, [serveti\\_ipk@hotmail.com](mailto:serveti_ipk@hotmail.com)

**Refik Havolli**

Drejtor në "Passable" , Prishtinë, Kosovë, [refik.havolli@gmail.com](mailto:refik.havolli@gmail.com)

**Apstrakt:** Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), si një mekanizëm i pavarur mbikëqyrës i Policisë së Kosovës, ka treguar përgjegjësi, profesionalizëm, paanshmëri, transparencë, besueshmëri dhe në mënyrë të vazhduar ka arritur të menaxhojë sfidat që e kanë shoqëruar këtë institucion, por edhe shërbimin policor në përgjithësi që nga gushti i vitit 2006 deri në ditët e sotme.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) funksionon bazuar në Ligjin Nr. 03/L-231, i cili ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2010.<sup>299</sup>

IPK-ja, duke pasur një komunikim të hapur me të gjithë akterët, si qytetarët, komunikim të brendshëm me pjesëtarët e policisë së Kosovës, me Legjislativin dhe Ekzekutivin, ka arritur me mjaft sukses të mbikëqyrë dhe të menaxhojë me efikasitet Policinë e Kosovës.

IPK-ja, si një mekanizëm i pavarur i mbikëqyrjes së Policisë së Kosovës, bazohet në dy funksione kryesore, në *inspektimin* e mënyrës së kryerjes së detyrave nga Policia e Kosovës dhe në *hetimin* e të gjitha ankesave drejtuar ndaj cilitdo pjesëtari të Policisë së Kosovës me qëllimin e sigurimit të një shërbimi policor të përgjegjshëm, profesional dhe demokratik.

IPK-ja, për të qenë më efikase mbikëqyrë nga tri nivele zyrtare: niveli i brendshëm, niveli i parlamentit dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme.

**HYRJE**

IPK-ja, si një mekanizëm i pavarur, duke ushtruar autorizimet e veta ligjore, aktivisht do të jetë kontribuuese në përmbushjen e misionit dhe të qëllimeve të parashtruara për të siguruar një shërbim policor cilësor, të përgjegjshëm, transparent, llogaridhënës duke u bazuar në ligjet dhe standardet e kërkuara. Qëllimi i veprimtarisë së IPK-së është që me profesionalizëm të parandalojë, të zbulojë e të hetojë veprat e ndryshme të paligjshme të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës në çdo kohë. IPK-ja mund të inspektojë dhe hetojë të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës pa dalluar profilin e tyre të menaxhimit, pozitën apo gradën për shkeljet disiplinore që ata mund të kenë kryer. Të gjitha inspektimet dhe hetimet bëhen duke u bazuar në ligjin e IPK-së. IPK-ja pranon të gjitha ankesat nga qytetarët të cilat janë adresuar kundër ndonjë punonjësi të Policisë së

---

<sup>299</sup> <http://ipk.rks.gov.net/rreth-nesh/historiku/>

Kosovës dhe me seriozitetin e përkushtimin maksimal i shqyrton ato duke u dhënë atyre vëmendjen dhe trajtimin e duhur. Detyrë me rëndësi e IPK-së është gjithashtu të ndihmojë Policinë e Kosovës që ajo të bëjë një shërbim cilësor dhe të zhvillohet si një Institucion demokratik, duke u bazuar në standardet evropiane policore, të cilat janë të përcaktuara në Kodin Evropian të Etikës Policore.

Kryeshefi ekzekutiv i IPK-së ka kompetencë të plotë mbi IPK-në. Ai sipas hierarkisë i përgjigjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është i pavarur nga Policia e Kosovës. IPK nuk ndërhyr në kompetencat e PK-së, por ajo e ndihmon dhe udhëzon si t'i përmirësojë mënyrat për ti arritur tri qëllimet kryesore, që janë: Efektshmëria, Pajtueshmëria dhe Zotësia.

### QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij punimi është që përvojat e fituar nga puna disavjeçare në IPK, t'i shpërndajmë me të tjerët që mund të kenë interesim apo i atakon gjatë jetës së përditshme. Jemi munduar të japim këndvështrimet tona nga dy pozicione të ndryshme, si pjesëtar i IPK-së dhe nga pozita e një qytetari dhe menaxheri biznesi, që dëshiron që rendi dhe ligji të respektohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të mos ketë shkelje të paargumentuar me fakte. Përfundimet dhe rekomandimet që do dalin nga ky punim mendojmë se do ndihmojnë edhe me shumë në forcimin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit më efektiv dhe më efikas. Krijimi i mekanizmave për argumentimin e shkeljeve do të ndihmonte që lëndët në gjykata të kryhen më me lehtësi.

### ROLI MBIKËQYRËS I IPK-SË NË SIGURIMIN E NJË SHËRBIMI POLICOR TË PËRGJEGJSHËM, PROFESIONAL DHE DEMOKRATIK

Në çdo vend demokratik, Policia ka për detyrë të mbrojë qytetarët dhe pasurinë e tyre, të zbulojë dhe parandalojë shkeljet e ligjit në fuqi, por mund të rezultojë sfiduese për atë, zbulimi dhe parandalimi i shkeljeve që ndodhin në vetë shërbimin policor. Kjo është edhe arsyeja kryesore përse është i nevojshëm ekzistimi i organeve të kontrollit të jashtëm mbi punën e policisë. Këto organe mbikëqyrëse synojnë të monitorojnë policinë për të garantuar që kjo agjenci policore vepron në përputhje me ligjin. Edhe pse këto organe janë jashtë zinxhirit komandues të Policisë, kontrolli i jashtëm është në gjendje të drejtojë (orientojë) veprimtarinë e policisë.

Mbikëqyrja e jashtme ka të bëjë me shqyrtimin dhe monitorimin e sjelljes policore nga institucionet që janë jashtë policisë. Mbikëqyrja e jashtme ka për qëllim parandalimin dhe identifikimin e sjelljeve të këqija në mënyrë që të përmirësojë shërbimin që policia ofron për publikun. Organizatat mbikëqyrëse në vendet demokratike janë të shumta dhe të shpërndara në shumë vende të botës dhe si të tilla nuk janë të integruara në zinxhirin komandues të policisë dhe monitorojnë nga jashtë aktivitetet policore për korrupsion apo abuzime të tjera.

Është një normë e pranuar gjerësisht sipas së cilës publiku duhet të ushtrojë kontroll mbi qeverinë dhe shërbimet publike, përfshirë edhe Policinë. Ky element është thelbësor për të garantuar se shërbimet publike u përgjigjen nevojave të publikut dhe që Policia të mos përfshihet në aktivitete të dëmshme dhe kundërligjshme ndaj interesave të publikut. Monitorimi në mënyrë demokratike i institucioneve mbi policinë luan një rol të rëndësishëm për ta bërë këtë forcë të zbatimit të ligjit, më të përgjegjshme dhe transparente ndaj nevojave të publikut të cilit i shërben. Thënë më qartë, mbikëqyrja e jashtme nxit besimin e publikut ndaj Policisë dhe avancojnë përmirësimin e shërbimeve policore.

Në vendin tonë, që pretendon të arrijë standardet më të larta ndërkombëtare të monitorimit policor, organizata policore mbikëqyrëse nga tri nivele zyrtare të mbikëqyrjes.

1. *Në nivel individual,*
2. *Në nivel të parlamentit,*
3. *Në nivel ekzekutiv.*

**1. Niveli individual**<sup>300</sup>, që konkretizohet përmes kontrollit të brendshëm (organizata policore ka të krijuar dhe strukturuar mekanizma kontrolli nën autoritetin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, që mbikëqyrin aktivitetet policore që janë të njohura si Njësia e Auditimit/Inspektimit dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale, në kuadër të së cilës funksionon Njësia e Hetimeve të Brendshme Disiplinore).

**1.1 Auditimi dhe Inspektimi.** -Nëpërmjet Auditimit dhe Inspektimit arrihet të avancohen standardet unike të punës dhe të menaxhohen në mënyrë sa më efikase dhe efektive burimet njerëzore dhe ato materiale në kuadër të PK-së. Gjithmonë kur Auditimi dhe Inspektimi has në parregullsi dhe keqmenaxhim, duhet të raportojë dhe të rekomandojë për hapat që duhet ndërmarrë në mënyrë që të mënjanohen, eliminohen këto shkelje dhe procedura që duhet ndjekur në të ardhmen.

**1.2. Komisioni i Brendshëm Disiplinor.** - Komisioni disiplinor zhvillon procedurë disiplinore ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, shqyrton rastet për shkelje të lehta disiplinore të hetuara nga Njësia e Hetimeve të

<sup>300</sup> Raportet vjetore të PK-së

Brendshme të Policisë së Kosovës, dhe kur të vërtetohet se shkelja disiplinore është kryer, shqiptohen masa disiplinore, duke marrë në konsideratë rekomandimet e Njësisë së Hetimeve të Brendshme.

**2. Niveli i parlamentit.** Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë Publike të Kosovës, që konkretizohet përmes komisionit të veçantë mbikëqyrës (ky lloj i mbikëqyrjes policore realizohet përmes Komisionit Parlamentar për Siguri, i cili në kuadër të fushëveprimit të tij ka edhe mbikëqyrjen e disa agjencive të tjera në fushën e sigurisë). Ky komision duhet të ketë takime së paku dy herë brenda vitit me PK-në, IPK-në dhe agjencionet e tjera për siguri publike. Autoritet për të raportuar para këtij komisioni është ministri i Punëve të Brendshme, por mund ta përfaqësojë edhe Drejtori i përgjithshëm i Policisë, i cili raporton para këtij komisioni për ecuritë dhe zhvillimet policore. Po ashtu edhe IPK-ja, përmes që raporton te Ministri i Punëve të Brendshme, raporton te ky komision për punën dhe të arritjet.

**3. Nivel ekzekutiv,** që konkretizohet përmes mbikëqyrjes nga një agjenci e pavarur jashtë zinxhirit komandues të Policisë (Ministria e Punëve të Brendshme këtë lloj mbikëqyrjeje e ushtron përmes të Inspektoratit Policor të Kosovës, i cili është edhe pjesë e shtjellimeve të këtij punimi).

Projekti i themelimit të IPK-së ishte hartuar në shtator të vitit 2005, ndërsa sendërtimi i këtij projekti fillon nga gushti 2006 me ekspertë të OSBE-së që vinin nga Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-t, të cilët kishin analizuar modelet më të avancuara botërore të mbikëqyrjes policore për të krijuar modelin kosovar të mbikëqyrjes së pavarur policore. Inspektorati Policor i Kosovës, si koncept, ishte themeluar si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kishte pavarësi të plotë nga Policia e Kosovës dhe ishte në varësi të ministrit të Punëve të Brendshme, përjashtimisht aspektit operacional.

Në vitin 2008 u miratua Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke zëvendësuar rregulloren e UNMIK-ut, që ishte baza ligjore e themelimit të IPK-së. Ky ligj kishte pothuajse të njëjtën përmbajtje sikurse edhe rregullorja e UNMIK-ut, por me disa ndryshime të cilat fuqizonin IPK-në si një mekanizëm i jashtëm i mbikëqyrjes policore, i pavarur nga Policia e Kosovës, e cila kishte mandat inspektimin e strukturave policore dhe hetimin disiplinor të shkeljeve të lehta dhe të rënda të pjesëtarëve të policisë. Kjo fazë përbën edhe kohën e zhvillimit profesional të IPK-së në aspektin e përvojës, në drejtim të pjekurisë institucionale përmes mandateve të saj, duke u përkujdesur që Policia e Kosovës të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e saj në përputhje me Kodin Evropian të Etikës Policore. Në vitin 2010 u vendos që ligji për IPK-në të rishikohet dhe të amendamentohet dhe IPK të merrte edhe mandatin shtesë që të hetonte edhe shkeljet e punonjësve të Policisë që përbënin vepër penale, si dhe personeli i saj operativ të ketë autorizime policore. Gjatë viteve 2010 dhe 2015, IPK kishte hyrë në fazën e pjekurisë së saj duke nxjerrë të gjitha aktet nënligjore përcjellëse të ligjit të ri, duke hartuar planin e saj zhvillimor strategjik, duke dyfishuar numrin e personelit të saj operativ, duke punuar në mënyrë intensive për ngritjen e vizibilitetit të organizatës te qytetarët përmes një komunikimi proaktiv dhe duke ofruar shërbimet më afër qytetarëve.

Inspektorati Policor i Kosovës ishte paraparë të formohej edhe me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/54<sup>301</sup>, ngase në nenin 9 (Inspektorati i Policisë), në pikën 9.1 thuhet: 'Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e formon Inspektoratin e policisë për të:

- a) *bërë kontrollime dhe inspektime në Shërbimin Policor të Kosovës dhe për të raportuar për përmbushjen dhe efektshmërinë e këtij shërbimi në arritjen e objektivave, dhe*
- b) *hetuar pohimet për kryerjen e shkeljeve të rënda disiplinore nga policët ose personeli civil i Shërbimit Policor të Kosovës dhe nëse ka rekomandime për ndonjë ndëshkim të cilin duhet shqiptuar, t'ia paraqesë Këshillit për Emërime të Larta dhe Disiplinë Policore' (KELDP).*

**Objekt i veprimtarisë së i IPK-së është<sup>302</sup>:**

- ❖ Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
- ❖ Inspektimi i strukturave dhe i funksioneve të policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
- ❖ Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e policisë së Kosovës.
- ❖ Hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policorë me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutiv;
- ❖ Kur ekziston dyshimi i bazuar se drejtori i përgjithshëm i policisë ka kryer shkelje disiplinore, kryeministri mund të autorizojë IPK-në për zhvillim të hetimeve disiplinore. IPK-ja pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton kryeministrit për të gjeturat;

<sup>301</sup> Rregullore e UNMIK-ut nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese te Shërbimit Policor te Kosovës, 20.12.05

<sup>302</sup> Plani Strategjik i IPK-së

- ❖ Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

Sa i përket infrastrukturës ligjore që lidhet me aktivitetet e kësaj agjencie, në këtë periudhë ka hyrë në fuqi edhe një<sup>303</sup>, e cila në mënyrë të detajuar kishte paraparë autorizimet dhe detyrat e personelit të agjencisë në fushën e inspektimeve dhe hetimeve të shkeljeve disiplinore.

#### **IPK-ja dhe funksionet e saj**

IPK-ja është një mekanizëm i pavarur i mbikëqyrjes së Policisë me dy funksione kryesore:

- a) **Inspektimi** i mënyrës së kryerjes së detyrave nga ana e Shërbimit Policor të Kosovës në një varg të definuar të funksioneve menaxhuese, në lidhje me saktësinë, efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi, dhe
- b) **Hetimi** i të gjitha ankesave për sjellje të keqe të policëve të Shërbimit Policor të Kosovës, pa dallim grade.

Sipas rregullit, në çdo vit kalendarik IPK-ja paraqet një raport të detajuar për mënyrën e kryerjes së detyrave policore, duke përfshirë analiza e rekomandime për reformat organizative dhe kjo i mundëson Ministrisë së Punëve të Brendshme që duke qenë plotësisht e informuar, të marrë vendime ndaj politikave që kanë të bëjnë me çështjet policore. Përveç kësaj, IPK-ja përgatit dosjet e rasteve lidhur me ankesat formale për sjelljet e pahijshme dhe i përcjell rekomandimet sipas nevojës ose ndryshe për një shqyrtim disiplinor nga Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë Policore (KELDP).

Me gjithë faktin se Policia është organizatë e re dhe njëra ndër modelet më të mira të policisë demokratike në rajon, ajo është në zhvillim e sipër. IPK-ja do t'i ndihmojë kësaj force policore të zbatimit të ligjit në zhvillimin si një institucion demokratik. Këtë e bën duke aplikuar standardet evropiane policore, duke e vlerësuar punën e menaxhmentit policor, derisa këto standarde janë definuar në Kodin Evropian të Etikës Policore (KEEP). Asnjë organizatë policore në rajon nuk e ka mënyrën e njëjtë të vlerësimit të punës. Në këtë mënyrë dhe në këtë drejtim, IPK-ja do të ndihmojë menaxherët policorë në sigurimin e pajtueshmërisë me standardet e Këshillit Evropian.

Roli i IPK-së nuk duhet të kuptohet si negativ nga policët dhe menaxherët ose si ndërhyrje e padëshirueshme në veprimet dhe aktivitetet e tyre policore. Inspektimet kanë për qëllim të arrijnë vetëm rezultatet pozitive. Çdo vit kalendarik, puna e inspektimeve do të rezultojë me një raport vjetor të mënyrës së kryerjes së detyrave nga ana e Policisë. Raporti me analiza të thukëta të veprimeve menaxheriale që identifikojnë anët pozitive dhe negative ofron rekomandime praktike e reale lidhur me ndryshimet që mund të përmirësojnë mënyrën e kryerjes së detyrave në të ardhmen. Vendimi për të vepruar ndaj këtyre rekomandimeve mbetet te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe vlerësohet se ato do ta ndihmojnë atë në detyrat për zhvillimin e mëtejshëm organizativ.


Përgjegjësia e IPK-së për të hetuar ankesat për shkeljet e rënda duhet të shikohet po ashtu në pikëpamje pozitive. Puna e IPK-së do ta ndihmojë Policinë që t'i demonstrojë popullatës se është plotësisht e përgjegjshme dhe se ankesat për sjellje të këqija do të hetohen në mënyrë të drejtë nga një organ i pavarur dhe jo nga policët e tjerë. IPK-ja do të sigurohet se të drejtat e policëve që akuzohen për sjellje të keqe respektohen, duke zbatuar mënyrën rigorozë dhe parimin se një polic është i pafajshëm derisa nuk shpallet fajtor. Për këtë arsye, IPK-ja nuk do të hyjë në kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë apo të ndonjë zyrtari të lartë policor. Nuk do të ndërhyjë gjithashtu në kompetencat policore për punët operative policore. Në vend të kësaj, IPK-ja do të ndihmojë menaxherët policorë që të përmirësojnë mënyrat në të cilat ata arrijnë tri qëllime kryesore:

- **Efektshmërinë:** duke u siguruar se qëllimet e Policisë janë arritur,
- **Pajtueshmërinë:** duke u siguruar se qëllimet policore janë arritur në pajtueshmëri të plotë me ligjet e aplikueshme dhe standardet evropiane,
- **Zotësinë:** duke u siguruar se qëllimet policore janë arritur në mënyrën më fitimprurëse, duke ua bërë të ditur taksapaguesve të vendit, punën e policëve.

Struktura e përgjithshme e organizimit të brendshëm të IPK-së

Për realizimin detyrave, objektiveve IPK-ja ka ndarë detyrat dhe përgjegjësit e veta në pesë departamente të cilat japin llogari te kryshefit ekzekutiv.

<sup>303</sup> Urdhëresa administrative nr. 2006/9 për zbatimin e Rregullores se UNMIK-ut nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës, 6 qershor 2006.



Në fillim të funksionalizimit të IPK-së nuk ka ekzistuar ndonjë strukturim organizativ bazuar në funksionet e përcaktuara me Rregullore. Grupi i parë prej njëzetë (20) inspektorëve nën udhëheqjen e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së janë përzgjedhur me anë të një konkursi publik të drejtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Përzgjedhja e personelit inspektues ka kaluar në disa faza të konkurrimit, përfshirë: aplikimin bazuar në shpalljen e konkursit të hapur, selektimin e aplikacioneve bazuar në kritere të konkursit, organizimin e testit me shkrim, organizimin e intervistave me gojë dhe verifikimin e të kaluarës së kandidatëve potencialë.

Grupi i parë i inspektorëve të përzgjedhur si nëpunës civilë në funksion të kompetencës inspektuese ka filluar punën më 3 korrik të vitit 2006, nga e cila ditë, grupi i inspektorëve i është nënshtruar një trajnimi në kohëzgjatje prej 30 javëve të udhëhequr nga Ekipi implementues i OSBE-së.

#### Fushat e menaxhimit policor të IPK-së

IPK-së në bazë të legjislacionit i lejohej të kryejë inspektime në këto fusha të menaxhimit policor

- *Menaxhimi i ndërtesave të policisë,*
- *Menaxhimi i buxhetit, financave dhe prokurimit,*
- *Menaxhimi i burimeve njerëzore,*
- *Menaxhimi i autoparkut dhe pajisjeve,*
- *Menaxhimi i armëve të zjarrit, municionit dhe i armëve,*
- *Menaxhimi i arrestimeve dhe i burgosjeve,*
- *Menaxhimi i krimeve kundër pakicave etnike dhe kundër lirisë së lëvizjes,*
- *Menaxhimi i patrullave të trafikut dhe i sigurisë në rrugë,*
- *Menaxhimi i hetimit të krimeve dhe i zbulimit,*
- *Menaxhimi i ankesave kundër policëve dhe hetimi i shkeljeve disiplinore,*
- *Menaxhimi i planeve për policinë në nivel lokal dhe i nismave për sigurinë e komuniteteve dhe për kryerjen e detyrave policore në nivel të komunitetit,*
- *Menaxhimi i përpunimit të të dhënave personale dhe i respektimit të ligjit në fuqi.*

Në fillim të vitit 2007, IPK-ja me mbështetjen e MPB-së ka shpallur konkursin e dytë publik për pranimin e grupit të dytë prej njëzetë (20) inspektorëve hetues për të kompletuar strukturën e saj në funksion të kompetencës hetuese. Përzgjedhja e kandidatëve potencial i është nënshtruar një procedure të njëjtë të selektimit sikur grupi i inspektorëve. Grupi i inspektorëve hetues i është nënshtruar fazës 24 javore të trajnimit të implementuar nga Ekipi implementues i OSBE-së. Fushat e trajnimit të cilave i janë nënshtruar hetuesit kanë qenë: shkathësitë e përpilimit të raporteve, shkathësitë e hetimit dhe intervistimit, menaxhmenti themelor dhe njohuritë nga ligji i aplikueshëm. Në përfundim të kësaj periudhe trajnuese, në tetor të vitit 2007, MPB-ja dhe



OSBE-ja kanë certifikuar hetuesit e rinj, duke i fuqizuar me kompetenca hetuese në fushën e hetimit disiplinor policor.

Sa i përket funksionit hetues, IPK-ja ka autoritet të hetojë të gjitha supozimet për shkelje të rënda disiplinore nga pjesëtarët e Policisë, të të gjitha gradave dhe kjo agjenci vepron sipas parimit që një organ i pavarur nga Policia duhet të hetojë ankesat për shkelje të rënda disiplinore. Sipas legjislacionit të atëhershëm, çfarëdo ankese nga qytetarët do t'i dërgohet IPK-së, ku kjo e fundit do të vlerësojë dhe regjistrojë atë në regjistrat e nevojshëm. Në fazën e vlerësimit do vendoset nëse supozimi për shkelje konsiderohet si vepër penale, shkelje e lehtë apo e rëndë disiplinore. Në rastet kur vlerësohet se ankesa ka elemente për përfshirje të punonjësit policor në vepër penale, rasti procedohet në prokurorinë kompetente për ndjekje penale. Kur vlerësohet se mund të ketë shkelje të lehtë disiplinore, rasti procedohet në Polici për hetim disiplinor nga Njësia për standarde profesionale. Në rastin tjetër, kur ka elemente të shkeljes së rëndë disiplinore, IPK-ja ndal ankesën për të zhvilluar hetimet, konsideruar si mandat të saj këtë lloj të hetimit.

Meqë këto dy grupe inspektorësh funksiononin si sektorë funksionalë, me nevojën për një organizim më të gjerë organizativ, me një përkrahje edhe të shërbimeve mbështetëse dhe administrative të saj, me iniciativë të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ministri i Punëve të Brendshme, më 15 gusht të vitit 2007 kishte aprovuar strukturën e organizimit të brendshëm, e cila ishte e përbërë nga dy (2) departamente operative (Departamenti i inspektimit dhe Departamenti i hetimit) dhe Administrata e përbërë nga disa zyra (buxhet e financa, prokurim, transport, logjistikë, teknologji informative) në mbështetje të departamenteve operative. Sipas kësaj strukture, sektorët operativë janë fuqizuar në departamente të udhëhequra nga drejtorët, derisa administrata ishte vendosur të menaxhohej nga një koordinator administrate

Në vazhden e nxjerrjes së ligjeve që lidhen me obligimet që dalin nga Pakoja e Ahtisarit, më 20 janar të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-036 nr. për Inspektoratin Policor të Kosovës. Ky Ligj i hyrë në fuqi më 1 korrik të vitit 2008 ka përcaktuar organizimin, funksionet dhe autorizimet e IPK-së. Gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë edhe disa akte nënligjore që burojnë nga ligji.

Gjatë vitit 2010, në vazhden e përpjekjeve për forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit, si dhe të luftimit të korrupsionit, përfshirë edhe atë në Polici, me përkrahjen e përfaqësuesve të Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), ICITAP-it, OSBE-së, Policisë së Kosovës, IPK-së dhe MPB-së, ligji aktual i IPK-së i është nënshtruar ndryshimeve dhe plotësimeve të nevojshme. Ligji nr. 03/L-231 për IPK-në i miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në tetor të vitit 2010, ndryshon thellësisht natyrën e funksioneve të Departamentit të Hetimeve, duke e fuqizuar atë me autorizime të policisë gjyqësore në zhvillimin e hetimeve penale, por duke fuqizuar edhe më tepër rolin inspektues të IPK-së. Ligji hap rrugë që të vazhdohet me zbatimin e kompetencave inspektuese, cakton një afat gjashtëmuor për të filluar me funksionin e ri hetues në fushën penale, nga momenti kur krijohet kushtet për të bërë një gjë të tillë.

### **NDRYSHIMI I STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË IPK-SË**

Në vitin 2011, me iniciativë të menaxhmentit të organizatës dhe rekomandim të ekspertëve të ICITAP-it dhe EULEX-it është ndryshuar struktura organizative e IPK-së, ku me aprovimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, (z. Bajram Rexhepi), në kuadër të IPK-së strukturohen pesë (5) departamente, prej të cilave, katër (4) operative (përfshirë Departamentin e hetimeve, Departamentin për analizimin e informacionit dhe menaxhimin e ankesave, Departamentin e testit të integritetit dhe Departamentin e inspektimeve) dhe Departamentin e administratës dhe shërbimeve mbështetëse si mbështetës të departamenteve

IPK-ja në vitin 2012 rekruton dhe trajnon edhe 15 hetues (inspektor të rinj) duke rritur kështu kapacitetet njerëzore. Viti 2017 e gjen Inspektoratin me strukturë organizative të re e cila dita ditës po zhvillohet si në profesionalizëm po ashtu edhe në zgjerimin e kapaciteteve njerëzore. Këtë vit planifikohet që IPK të rritet edhe për së paku 10 inspektor.

Që nga themelimi, IPK-ja mund të mburret për kontributin e dhënë në orientimin e forcës policore për t'u shndërruar në një polici efikase dhe të përgjegjshme. Kuptohet se një kontribut të veçantë kanë dhënë edhe partnerët strategjikë të IPK-së, si OSBE-ja, ICITAP-i, EULEX-i dhe MPB-ja. Disa prej këtyre kanë mbështetur në mënyra të ndryshme organizatën, në rrugën e saj për të arritur misionin e vënë ligjor. Mbështetja e partnerëve është orientuar në dhënie të këshillave lidhur me aktivitetet, në përkrahjen përmes trajnimeve për personelin, sponsorimin e vizitave jashtë vendit dhe ofrimin e pajisjeve të nevojshme për punë operative.

Hartimi dhe implementimi i fazës së parë të projektit të regjionalizimit të IPK-së ka bërë që të krijohet një sistem i brendshëm i kontrollit dhe i cilësisë në raport me shërbimet që IPK-ja ofron për qytetarët. Funksionalizimi i tri zyrave regjionale (Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicë e Veriut) ka krijuar më shumë mundësi për qytetare, policinë dhe IPK-në për të qenë më efektiv në aspektin e komunikimit të ndërsjellë.


Në vitin 2008 Kosova finalizon vullnetin e përhershëm të qytetarëve të saj duke shpallur pavarësinë dhe duke miratuar kushtetutën e saj si një shtet i pavarur demokratik me një sistem parlamentar të qeverisjes dhe duke zëvendësuar rregulloret e UNMIK-ut me ligje të nxjerra nga përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Një ndër këto ligje ishte edhe ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Në vitin 2010, IPK, pas një analize të punës dhe mandateve të saj, kishte arritur në përfundim se hetimi i vetëm shkeljeve disiplinore të policëve pa përfshirë edhe ato penale, të cilat deri në atë kohë ishin ende në mandatin e Policisë së Kosovës që të hetonin vetveten në aspektin penal, nuk ishte e mjaftueshme. Prandaj, me përkrahjen MPB-së e edhe të partnerëve ndërkombëtare siç ishte ICITAP (Departamenti i Drejtësisë, Ambasada e SHBA-së Kosovë), OSBE, EULEX, EU etj. u vendos që ligji për IPK-në të rishikohet dhe të amendamentohet.

Qëllimi kryesor i këtij rishikimi ishte në atë që IPK të merrte edhe mandatin shtesë që të hetonte edhe shkeljet e punonjësve të Policisë që përbënin veprë penale me Kodin Penal të Kosovës, si dhe personeli operativ i IPK-së të ketë autorizime policore. Në dhjetor të vitit 2010, pas miratimit në Kuvendin e Kosovës, ky ligj hyri në fuqi duke i dhënë IPK-së mandatin për hetime penale ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës.

Puna e IPK-së nëpër vite (2007-2016)<sup>304</sup>

Viti	Inspektime		Gjith. Inspektime	Rekomandime	Lëndë të trajtuar dhe të pranuar nga IPK-ja	
	Të rregullta	Të jashtë-zakonshme			Të pranuar	Me kallëzim penal
2006	6	0	6	43	-	-
2007	11	4	15	64	-	-
2008	8	7	15	83	2024	482
2009	8	6	14	41	1688	559
2010	4	4	8	64	1185	408
2011	4	-	4	35	649	143
2012	5	3	8	57	1078	292
2013	4	2	6	63	1050	328
2014	5	2	7	50	1622	305
2015	5	3	8	54	1237	220
2016	5	4	9	60	1362	241
<b>Gjith</b>	<b>59</b>	<b>35</b>	<b>94</b>	<b>614</b>	<b>11.895</b>	<b>2.978</b>



Mundësitë të cilat ofron IPK-ja se si qytetarët mund të parashtrajnë ankesat e tyre janë:

- Përmes dorëzimit në formë fizike (dorëzimit fizik ose me postë),
- Përmes dorëzimit në formë elektronike,

<sup>304</sup> Raporti vjetor i IPK-së 2007-2016

- Përmes deklarimit me anë të telefonit (080003333),
- Përmes dhënies së deklaratës personale, direkt tek personeli i DSHMA-së,
- Përmes kutive të ankesave,
- Përmes dorëzimit me anë të palëve tjera.

#### **KONKLUZIONE**

IPK-ja, është e frymëzuar dhe kërkon që të vërtetohet pajtueshmërinë e policisë me Kodin Evropian të Etikës Policore si një kornizë e standardeve për kryerjen e detyrave policore në mënyrë demokratike.<sup>305</sup>

IPK ka arritur që të fuqizoj besimin e saj tek Policia e Kosovës përmes inspektimeve kualitative me rekomandime konkrete duke mbajtur takime të rregullta për të diskutuar dhe argumentuar të gjeturat e inspektimeve dhe përmbajtjen e rekomandimeve konkrete.

Ky fuqizim i besimit është theksuar edhe te qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo religjioze e cila është dëshmuar me transparencën dhe korrektësinë përmes publikimit të raporteve të inspektimeve dhe cilësisë së hetimeve.

IPK ka arritur që me sukses të trajtojë të gjitha ankesat e pranuar dhe me një efikasitet të lartë t'i përcjellë në Policinë e Kosovës apo Prokurori për trajtim të mëtutjeshëm.

IPK-ja vazhdimisht e ka njoftuar Policinë e Kosovës lidhur me aktivitetet hetimore dhe për të gjeturat nga inspektimet e ndërmarra si dhe vazhdimisht ka informuar qytetarët dhe grupet e interesit, duke treguar transparencë dhe gatishmëri për të punuar edhe me të tjerët të cilët ndajnë të njëjtin vizion për të pasur një polici profesionale dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të saj

Inspektorati Policor i Kosovës aktivitetin e saj e ka zhvilluar me burime njerëzore të kufizuara në vitin 2006 vetëm 20 inspektor policor dhe një departament, gradualisht duke u zhvilluar tani IPK-ja ka në dispozicion 56 inspektor me 5 departamente dhe 16 punonjës mbështetës. Vlen të theksohet se viti 2017 do ta gjejë IPK-edhe me 10 inspektor të rijë falë profesionalizmit të treguar që ka bindur institucionet për mbështetje financiare.

---

<sup>305</sup> <http://ipk.rks.gov.net/rreth-nesh/historiku/>